

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 DHE SPORTIT
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

MODEL TESTI I MATURËS SHTETËRORE
 LËNDA: QYTETARI DHE PSIKOLOGJI

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej **60 pikë**.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Testi ka **20 pyetje me zgjedhje (alternativa)** dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda zonës së kufizuar me vijë. Çdo përgjigje e shkruar jashtë vijave kufizuese, nuk do të vlerësohet.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	6	7	8	10	13	14	16	17	27
Pikët									
Kërkesa	28	29	31	33	34	35	36		
Pikët									

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

Qytetari

1. Kodi Civil, mes të tjerave, shërben për rregullimin e: 1 pikë
- A) kundravajtjeve penale.
 - B) administratës shtetërore.
 - C) marrëdhënieve pasurore.
 - D) tipareve morale të sjelljes.
2. Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë. Këto rregulla të detyrimeve dhe të drejtave i përcakton Kodi: 1 pikë
- A) Civil.
 - B) Penal.
 - C) Familjes.
 - D) Administrativ.
3. Kushtetuta është akti juridik më i rëndësishëm që përmban: 1 pikë
- A) rregulla administrative.
 - B) dënime për vepra penale.
 - C) norma në një fushë të caktuar.
 - D) parimet themelore të një shteti.
4. Kushtetuta ka epërsi ndaj ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore, çdo ligj duhet të jetë në pajtueshmëri me të. Ky parim lidhet me: 1 pikë
- A) barazinë.
 - B) sovranitetin.
 - C) shtetin e së drejtës.
 - D) kushtetutshmërinë.
5. E drejta për arsimim është e drejtë themelore e ligjëruar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila i takon kategorisë së të drejtave: 1 pikë
- A) civile.
 - B) politike.
 - C) sociale.
 - D) për zhvillim.
6. Kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj. Shpjegoni dy rastet kur kufizohen këto të drejta. 2 pikë
1. _____
2. _____
7. Të drejta e njeriut janë të grupuara në kategori (breza).
- a) Identifikoni cilat të drejta bëjnë pjesë në kategorinë e parë: 1 pikë
- _____

b) A mbrohen njësoj, e drejta e pronës dhe e drejta për mjedis? Argumentoni qëndrimin. **1 pikë**

8. Arsimi ka një vëmendje të veçantë për politikat e vendeve, megjithatë shfaqen problematika që kërkojnë trajtim. Shpjegoni problematikat që lidhen me: **3 pikë**

1. Analfabetizmin funksional _____

2. Gjithëpërfshirjen _____

3. Konfliktet dhe dhunën _____

9. Joni nuk është i përfshirë në marrëdhënie me shokët e shoqet e klasës. Ai nuk bën asnjë përpjekje për t'u përshtatur në situatat e ndryshme që krijohen në klasë. Kjo situatë lidhet me komponentin e shëndetit: **1 pikë**

- A) fizik.
- B) social.
- C) mendor.
- D) fiziologjik.

10. Vlerësoni tre parime në të cilat mbështeten ligjet në mbrojtjen e shëndetit për të gjitha shtresat e shoqërisë. **3 pikë**

1. _____

2. _____

3. _____

11. Ligji për mbrojtjen e mjedisit përcakton si objektiv: **1 pikë**

- A) mospërdorimin e burimeve natyrore.
- B) përdorim vetëm të teknologjisë jo ndotëse.
- C) përdorimin e burimeve përtej kapaciteteve rigjeneruese.
- D) mbrojtjen dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit.

12. Ruajtja e mjedisit vlerësohet si përgjegjësi: **1 pikë**

- A) vetëm ligjore.
- B) vetëm morale.
- C) vetëm individuale.
- D) ligjore dhe individuale.

13. Si konsumator kemi të drejta dhe detyrime. Shpjegoni rëndësinë që kanë detyrimet duke u ndalur në tri përgjegjësi të konsumatorit. **3 pikë**

1. _____

2. _____

3. _____

14. Një nënë e re kërkonte leje nga puna, ajo paraqiti raportin e foshnjës së sëmurë. Ajo pretendon për këtë kërkesë referuar Kodit të Punës, ndërsa pronari gjykon se një pretendim të tillë mund ta ketë vetëm në sektorin shtetëror. Vlerësoni kush ka të drejtë në këtë situatë duke argumentuar përgjigjen tuaj. **2 pikë**

15. Kodi Rrugor përcakton se, për të siguruar dhe mbrojtur jetën e njerëzve, kufiri maksimal i lejuar i shpejtësisë në rrugët interurbane kryesore është: **1 pikë**

- A) 90 km/orë.
- B) 100 km/orë.
- C) 110 km/orë.
- D) 120 km/orë.

16. Erjoni është shofer i ri, ai gjykoi se duhej të kalonte i pari edhe pse pas tij ndodhej një zjarrfikëse që po qarkullonte pa qenë në shërbim urgjence. Erjoni kaloi i pari, por ishte në mëdyshje për veprimin e tij. Vlerësoni nëse veprimi i drejtë ose jo Erjoni. **2 pikë**

17. Evidentoni rëndësinë që ka ushtrimi i të drejtës për informim duke përcaktuar tre aspekte. **3 pikë**

1. _____
2. _____
3. _____

18. Për bashkëjetesën në komunitet janë përcaktuar rregulla e norma ligjore. Cili nga pohimet e mëposhtme është detyrim për banorët që jetojnë në bashkëpronësi: **1 pikë**

- A) Të paguash tarifën e administrimit.
- B) Të informohesh nga Asambleja për vendimet e marra.
- C) T'i parashtrosh Asamblesë propozime për administrim.
- D) Të marrësh pjesë në forume për administrimin e ndërtesave.

Psikologji

19. Drejtimi i psikologjisë, që mendon se sjellja e njeriut ndikohet nga mjedisi që e rrethon, është: **1 pikë**
- A) konjitivizmi.
 - B) bihevjorizmi.
 - C) humanizmi.
 - D) psikanalitika.
20. Hormoni tiroksinë gjendet në gjëndrën: **1 pikë**
- A) e pankreasit.
 - B) e hipofizës.
 - C) e tiroides.
 - D) limfatike.
21. Ekuilibri trupor rregullohet nga: **1 pikë**
- A) sistemi retikular.
 - B) hipotalamusi.
 - C) palca e zgjatur.
 - D) truri i vogël.
22. Strategjitë e orientuara nga mbrojtja ndaj stresit: **1 pikë**
- A) dallojnë stresorët.
 - B) zbusin pasojat e stresit.
 - C) planifikojnë hapa konkretë.
 - D) kryejnë veprimet e planifikuara.
23. Teknika e formësimit në procesin e të mësuarit të sjelljes, lidhet me: **1 pikë**
- A) heqjen e reagimit të padëshiruar.
 - B) përforcimin e pjesshëm të një veprimi.
 - C) ndëshkimin për mospërsëritje të sjelljes.
 - D) afrimin gradual me sjelljen e dëshiruar.
24. Ju jeni duke vëzhguar dikë që është duke fjetur. Ai merr frymë qetë, thellë, ngadalë dhe trupi duket plotësisht i relaksuar. Ai është: **1 pikë**
- A) duke parë ëndrra.
 - B) në gjumin me LSHS.
 - C) në gjumin me LJSHS.
 - D) në gjumin paradoksal.
25. Përforcimi, si stimul që rrit mundësinë e përsëritjes së një reagimi që kryhet para tij, quhet përforcim dytësor pozitiv, nëse shoqërohet me: **1 pikë**
- A) përforcues pozitiv si paratë, dhuratat, buzëqeshja.
 - B) prezantimin e stimujve të pakëndshëm, si ndëshkimet.
 - C) përforcues të rëndësishëm për mbijetesë, si ushqimi, uji.
 - D) me heqjen ose me shtyrjen e stimujve që i interesojnë individit.

26. Dorëzimi para kërkesave të tjerëve, lidhet me: **1 pikë**

- A) paragjykimin.
- B) komplaincën.
- C) konformizmin.
- D) përshtypjen e parë.

27. Tregoni çfarë janë neurotransmetuesit dhe rolin që kanë në organizmin tonë: **2 pikë**

Çfarë janë: _____

Rolin: _____

28. Motivimi për sukses nxit njerëzit për arritjen e objektivave që iu vendosin vetes. Shpjegoni dy faktorë që ndikojnë në këtë motivim: **2 pikë**

1. _____

2. _____

29. Shpjegoni dy faktorë, që ndikojnë në krijimin e pasigurisë në sjelljen e adoleshentëve dhe konfliktet me të rriturit: **2 pikë**

1. _____

2. _____

30. Diskriminimet janë: **1 pikë**

- A) stereotipe që lidhen me familjen.
- B) paragjykime pasive dhe rastësore.
- C) veprime negative dhe tendencioze.
- D) veprime bazuar në fakte dhe përvoja.

31. Vlerësoni dy aftësi të njerëzve me inteligjencë të lartë emocionale: **2 pikë**

1. _____

2. _____

32. Trajtimi i sjelljes jonormale përmes barnave, elektroshokut dhe kirurgjisë në tru është karakteristikë e trajtimit: **1 pikë**

- A) transaksional.
- B) psikanalitik.
- C) kognitivist.
- D) biologjik.

33. Psikologët klasifikojnë tipe të ndryshme të kujtesës bazuar në llojin e informacionit që ruhet në të. Shpjegoni dy karakteristika të llojit të informacionit që ruhet në kujtesën: **4 pikë**

a)semantike

1. _____

2. _____

b) episodike

1. _____

2. _____

34. Evidentoni tre karakteristika të gjendjes së ndryshuar të ndërgjegjes: **3 pikë**

1. _____

2. _____

3. _____

35. Dalloni dy tipare të sjelljes jonormale: **2 pikë**

1. _____

2. _____

36. Bazuar në drejtimin e shkollës që përfaqësojnë, psikologët japin shpjegime për sjelljen jonormale. Shpjegoni tre karakteristika të trajtimit që psikologët e drejtimin bihevjorist bëjnë për sjelljen jonormale. **3 pikë**

1. _____

2. _____

3. _____
